

# GJINI CONSTRUCTION SHPK

## STATUT

### **Kreu I**

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

### **Neni 1:**

#### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi**

- (1) Sot, me date 27.06.2022 , une themeluesi , kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **Gjini Construction Sh.P.K.**
- (2) Themeluesi i shoqerise eshte: **z.Leonard Gjini.**

- Fshati Goriçaj, lagjja Ujesjells i Vjeter, rruga nacionale Pushimi i Shoferit-Gradishte,Km 2 , godine 1 kateshe me Nr.153.Shoqeria

### **Neni 2 :**

#### **Objekti :**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Rikonstrukcion dhe ndërtim objektesh civile, industrial dhe turistike. Ndërtim: rrugë, ujësjellësa, sisteme dhe rjete hidraulike, Ndërtim vepra hidraulike dhe hidroteknike, thellimi/drenimi/mbrojtje, punime special ndërtimi. Mirëmbajtje rutinë rrugë dhe vepra publike. Menaxhim projekti, investim dhe zhvillim prone. Ndërtime struktura druri dhe metalike. Gërmim dheu, murembajtëse, stabilizim skarpate dhe përforcim dhera. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime nëntokësore, ura dhe vepra.

### **Neni 3:**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e papercaktuar.

### **Neni 4:**

#### **Selia.**

- (1) - FshatiGoriçaj, lagjja Ujesjells i Vjeter, rruga nacionale Pushimi i Shoferit-Gradishte,Km 2 , godine 1 kateshe me Nr.153.Shoqeria
- (2) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronike eshte si vijon: **leonardgjini@live.com**

### **Kreu II**

#### **Kapitali**

## **Neni 5**

### **Kapitali themeltar**

( 1) Kapitali themeltar fillestar I shoqerise eshte 100 000 leke . Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues:  
**Leonard Gjini**
2. Zoterues i 1 ( nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben :  
**100 % te kapitalit themeltare te shoqerise**

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

## **Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## **Neni 7 :**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) **Kontributit ne kapitalin e shoqerise.**
- b) **Shitblerjes.**
- c) **Trashegimise.**
- d) **Dhurimit.**
- e) **Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8.

##### **Organi Vendmarres:**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuar ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

b) ndryshimin e statutit.

c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.

ç) emerimi dhe shkarkimi I likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “ c “ dhe “ ç “ te kesaj pike.

dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimin e tjera ndaj administrates.

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

h) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortake tjetër apo nga nje person i trete.

Admintratori mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshine edhe mbledhjet vijuese me te njehtin rend dite.

#### Neni 9

##### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t’u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marr vendime, pavaresisht parregullsisë.



## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem , nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjet elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me larte, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejten rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve.**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) **Percaktimi I politikave tregtare te shoqerise.**
- b) **Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.**
- c) **Emerimin e shkarkimin i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.**
- d) **Percaktimin e shperblimeve.**
- e) **Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administartoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.**
- f) **Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.**
- g) **Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.**

Cdo ndryshim statiti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes.**

1. Ortaku mund te ushtroje te drejtene e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
  - a) **Vleresimin e veprimtarise se tij.**

- b) **Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.**
  - c) **Ngritjene e nje padie ndaj tij nga shoqeria.**
  - d) **Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.**
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emertimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 270 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si adminstratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
3. Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

#### **Te dhenat e identifikimit:**

##### **( emir mbiemri):**

- Leonard Gjini

### **Neni14**

#### **Kompetencat e Adminstratoreve**

Adminstaroret kane te drejte e detyrohen te:

- a) **Kryejne te gjitha veprimet e adminstrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.**
- b) **Perfaqesojne shoqerine tregtare.**
- c) **Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumnteve dhe te librave kontabel te shoqerise.**
- d) **Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetore, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozomet e fitimeve, i paraqisin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.**
- e) **Krijojne nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe egzistencen e shoqerise.**
- f) **Kryejne regjistrime dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.**
- g) **Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.**
- h) **Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut.**

Administratoret janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore të shoqërisë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit.**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryerë gjatë administritimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamerituara nga asambleja që i sjellin dem shqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17, 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqërië Tregtare”, administrator detyrohet.

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.  
b) të ushtrojë kompetencat që i njeh ligji dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita.  
c) të vlerësojë me përgjegjësi ceshtjet, për të cilat merret vendim.  
d) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë.  
dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesjen e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



3. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëmet e shkatuara, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët e Shoqërit Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme.
  - a) U kthen ortakeve kontributet.
  - b) U paguan ortakeve interesat apo dividente.
  - c) U shperndan aktive shoqërisë.
  - d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
  - e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimet financiare, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Kreu IV**

### **Viti financiar- ekspertet.**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar.**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet.**

Eksperti ka për të detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për ratet kur ai është i ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu**

### **Prishja – riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi.**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) **Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj.**
- b) **Me vendim të Asamblesë së Ortakëve.**
- c) **Me hapjen e procedurave të falimentimit.**
- d) **Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhjen me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.**
- e) **Me vendim të Gjykatës.**

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidator dhe shënuar në çdo dokument të nxjerr prej tij emrin e likidatorit dhe emertesen shtesë “ Shoqëria në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rastëve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të përcaktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

##### **Riorganizimi I shoqërisë bashkimi-ndarja.**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901, datë 14.04.2012, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### **Neni 20**



**Baza ligjore.**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohet dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare”, Kodit Civil dhe cfardo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**

**Mosmarrveshjet.**

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statiti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetent Gjykata Shqiptare.


**ORTAKU I VETEM**

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
GJINI CONSTRUCTION SHPK**

**LEONARD GJINI**

**Emer mbiemer**

**(neshkrimi)**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and lines, positioned below the text "(neshkrimi)".